



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
SENATI AKADEMIK**

VENDIM

Nr. 04, datë 28/06/2021

**PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT INSTITUCIONAL TË
ZGJEDHJEVE (KIZ) NË AKADEMINË E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**

Senati Akademik i Akademisë së Studimeve Albanologjike i mbledhur sot në datë 28/06/2021, mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, nenin 36, 37 (Senati Akademik), nenin 38 (Funksionet e Senatit Akademik), e nenin 131, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Akademinë e Studimeve Albanologjike", pasi diskutoi për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të KIZ, në zbatimin e nenit 6 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Akademinë e Studimeve Albanologjike":

VENDOSI

1. Zgjedhjen me votim të fshehtë të 5 (pesë) anëtarëve të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), në Akademinë e Studimeve Albanologjike, si më poshtë vijon:
 - a) Nevila Molla, Instituti i Arkeologjisë
 - b) Hasan Bello, Instituti i Historisë
 - c) Ervin Kaçiu, Instituti i IAKSA
 - d) Erjena Lamaj, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë
 - e) Ervin Kujtila, student
 2. Caktimin e sekretarit të KIZ,
Znj. Blerina Kuqi
 3. Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) i Akademisë së Studimeve Albanologjike, në zbatim të kërkesave të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Akademinë e Studimeve Albanologjike", të marrë masat e nevojshme për miradministrimin e procesit zgjedhor në Akademinë e Studimeve Albanologjike;
 4. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Akademisë së Studimeve Albanologjike
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
AKADEMIK PROF. DR. MARENGLËN VERLI**

